



Zyrës për Doktoraturë te Universitetit të Tetovës

Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Filozofik

Këshilli Mësimor - Shkencor i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës në mbledhjen e mbajtur më, **10.04.2020** solli vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin shkencor dhe profesional e dorëshkrimit të temës së doktoraturës me titull: **“Ridalja e nacionalizmit serb pas vdekjes së Titos dhe forcimi i politikës antishqiptare në Kosovë dhe Maqedoni në vitet 1981 ~ 1989”**, të kandidatit **Mr. sc. Sedat Kryeziu**.

Në bazë të vendimit **16 - 324/2** të datës, **10.04.2020**, komision i përbërë nga: **Prof.dr. Zeqirja Idrizi** (kryetar), **Prof. dr. Fehari Ramadani**, **Prof.dr. Zeqirja Rexhepi**, **Prof.dr. Isak Sherifi** (anëtarë) dhe **Prof. dr. Nebi Dervishi** (mentor), pasi lexoi materialin në dorëshkrim, Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës, i paraqet këtë:

REFERAT

Të dhëna biografike për kandidatin

Mr. sc. Sedat KRYEZIU, i lindur me 26.09.1975 në Suharekë (R. e Kosovës).
Në vitin akademik 1994/95 regjistroi studimet bazike në Universitetin e Prishtinës/Fakulteti Filozofik - Fusha e studimit, Histori. Për shkak të ndërprerjes nga lufta dhe qendrimi në botën e jashtme, studimet i mbaroi në vitin 2001. Menjëherë fillon punë në Gjimnazin e Suharekës si mësimdhënës i Historisë dhe Gjuhës Latine. Studimet posdiplomike i vazhdoi gjatë viteve 2005 – 2010 po ashtu në Universitetin e Prishtinës/Fakulteti Filozofik - Histori Moderne, shek. XV-XX ku edhe mbaroi me suksese, duke e marrë titullin **Master në Shkencat Historike**.
Në vitin 2015 – vazhdon studimet në ciklin e tretë, pranë Universitetit të Tetovës - Fakultetin Filozofik/Departamenti i Historisë, në fushën e studimit, Historia e Popullit Shqiptar – Periudha bashkëkohore dhe mori titullin, **Kandidat PhD**.

Nga viti 2015 vazhdon punën në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren, pranë Fakultetit Juridik dhe Fakultetit të Edukimit, si ligjërues i angazhuar për lëndët *Histori e Arsimit Kombëtar Shqiptar, Bazat e Shkencave Shoqërore me Metodologji dhe Histori e Shtetit dhe e së drejtës – me theks të veçantë të shtetit shqiptar.*

Kandidati doktorant, që nga fillimi i studimeve të ciklit të tretë e deri më sot, ka treguar përparim të caktuar të kënaqshëm në fushën e hulumtimit dhe punimin e temës. Kandidati me sukses ka realizuar tre konferencat doktorale, gjatë të cilave ka prezantuar rezultatet e hulumtimit. Mr.sc. Sedat Kryeziu gjatë studimeve të doktorale ka botuar dy punime shkencore, që janë të lidhura drejtpërdrejt me tezën e disertacionit, të njëjtat janë mbrojtur para panelit në Konferencën doktorale të organizuar me 29 shkurt 2020.

Punimet e botuara:

“Vështrim i shkurtër mbi disa nga projektet serbe për shpërnguljen e shqiptarëve dhe krijimin e Serbisë së Madhe” e ka botuar në Revistën shkencore periodike "GLOBAL CHALLENGE", që është botim i Akademisë Diplomatike Shqiptare, në maj 2017, si dhe punimin e dytë, të titulluar, **“Memorandumi i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë (ASHAS)j vitit 1986 dhe impakti i tij në ringjalljen e nacionalizmit serb”**, në revistën shkencore "KOSOVA", 44 - 2019. KDU: 94 (05), që botohet nga Instituti i Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë.

Informacione lidhur me lëndën e hulumtimit

Doktoranti, Sedat KRYEZIU, përmes tezës së tij të doktoraturës, *“Ridalja e nacionalizmit serb pas vdekjes së Titos dhe forcimi i politikës antishqiptare në Kosovë dhe Maqedoni në vitet 1981 ~ 1989”*, ka arritur që përmes një objektiviteti shkencor të shtjellojë zhvillimin e rrethanave dhe të faktorëve që çuan në rishfaqjen e nacionalizmit serb në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë (më tej: RSFJ), manifestimin e këtij nacionalizmi dhe pasojat që ai prodhoi për popujt tjerë jo serb në Jugosllavi, me theks të veçantë në Kosovë e Maqedoni, si dhe reagimin, ballafaqimin dhe qëndrimin e shqiptarëve kundrejt një politike të tillë gjatë viteve 1981-1989.

Shtjellimi i fenomenit të nacionalizmit serb është një temë e gjerë trajtimi i së cilës kërkon një studim të thellë e shumë-dimensional. Në vështrimin hyrës është përshkruar nacionalizmi në zanafillën e tij që e kishte në gjysmën e parë të shekullit XIX. Janë elaboruar shkurtimisht projektet serbe që në kontinuitet promovonin intolerancën e urrejtjën ndaj kombeve tjera. Mirëpo, teza gjerësishtë fokusohet vetëm gjatë periudhës 1981-1989. Përzgjedhja e periudhës në fjalë nuk është e rastësishme, ajo në fakt ngërthen në vete zhvillimin dhe rezultatet finale të nacionalizmit serb që zanafillën e kishin në procesin e decentralizimit të RSFJ-së, autonominë e krahinave, sidomos të Kosovës, dhe frikës nga shpërbërja e Jugosllavisë dhe humbjes së qëllimit tradicional të nacionalizmit serb – vendosjes së hegjemonisë serbe në RSFJ. Në këto rrethana, vdekja e Titos dhe demonstratat studentore të shqiptarëve në Kosovë më 1981 ndezën zjarrin e kamufluar të nacionalizmit serb.

Teza e hartuar e magistraturës në fjalë është ndarë në katër kapituj, që korrespondojnë me natyrën e çështjes së trajtuar.

Në Kapitullin e Parë : *(Premisat e rishfaqjes së nacionalizmit serb)* autori pretendon të shtjellojë rrethanat, ku u gjend RSFJ në fund të Luftës së Dytë Botërore. Pastaj, gjendjen dhe pozitën e popullsisë shqiptare, sistemin dhe zhvillimet politike, sidomos, ndryshimet politike të viteve 1966 e ato kushtetuese të viteve 1974, që si rezultat patën decentralizimin e RSFJ dhe akordimin e autonomisë së krahinave, që në fakt ishte edhe fillimi i heshtur i organizimit të nacionalizmit serb, që doli në skenë pas vdekjes së Titos dhe pas demonstratave studentore shqiptare në Kosovë, më 1981.

Vdekja e Titos, më 1980, paraqet një moment kthese në historinë e popujve, që atëherë jetonin në kuadër të RSFJ-së. Duke qenë se udhëheqja kolektive jugosllave, që pasoi Titon, nuk ishte në gjendje t'i ekuilibronte rrethanat dhe ta mbante gjendjen nën kontroll, u lind riaktualizimi i tendencave etnike. Gjatë pranverës së vitit 1981, studentët shqiptarë u ngritën në kërkim të të drejtave kombëtare dhe barazisë me popujt e tjerë në RSFJ. Një kërkesë e tillë hasi në reagimin e ashpër të strukturave shtetërore serbe e jugosllave, prapa së cilave fshihej nacionalizmi serb. Prandaj në **Kapitullin e Dytë:** *(Ngjarjet në muajt mars-prill të vitit 1981 dhe situata e krijuar pas tyre)* autori pretendon të ofrojë një vështrim të përgjithshëm rreth gjendjes në Kosovë e Maqedoni, pas vdekjes së Titos dhe demonstratave studentore në Kosovë, dhunën policore e ushtarake kundër shqiptarëve, diferencimin ideopolitik në institucionet universitare e

shkencore. Pra, duke atakuar elitën akademike shqiptare, për t'i hapur rrugë, kështu, synimeve për heqjen e Kushtetutës së vitit 1974 dhe për krijimin e parakushteve për rivendosjen e centralizimit në RSFJ, që ishte një nga detyrat kryesore të nacionalizmit serb.

Kapitulli i Tretë: (*Rishfaqja e nacionalizmit të heshtur serb 1981-1989*) shtjellon ngjarje të rëndësishme që ndodhën pas pranverës shqiptare të vitit 1981. Nacionalizmi serb, i cili kishte qëndruar latent, që nga koha e Rankoviqit, tani doli në skenë dhe filloi mobilizimi i tij, që si një proces merr formë të organizuar tek në vitin 1986. Të dirigjuar nga instanca të larta shkencore e religjioze, si nga: Kisha Ortodokse Serbe (më tej: KOS), Lidhja e Shkrimtarëve të Serbisë (më tej: LSHS), Akademia Serbe e Shkencave dhe Artave (më tej: ASSHA), grupe të vogla serbësh, sidomos në Kosovë, filluan ta ndërtonin një kauzë të rrejshme, duke inskenuar incidente etnike dhe situata të paqena, të cilat do të thellonin ndarjet etnike në Kosovë e do ta bindin opinionin publik jugosllav për pozitën e tyre të rëndë në Kosovë, ku si rezultat kishte qëllimin për arsyetimin e veprimeve politike dhe policore kundër shqiptarëve në Kosovë. Po ashtu, një trajtim i veçantë e shumëdimensional në këtë kapitull i jepet edhe Memorandumit të ASSHA-së të vitit 1986, që ishte çelësi programor i të gjitha veprimeve shkatërrimtare e gjenocidale të serbëve në Jugosllavi.

Kapitulli i Katërt: (*Përgatitja dhe zbatimi i planit për heqjen e autonomisë së vitit 1974 dhe revolta e shqiptarëve*) autori trajton ngjarje me rëndësi, të cilat fillojnë që nga ngritja e Sllobodan Millosheviqit në kreun e udhëheqjes komuniste në Serbi dhe realizimit të programit të përgatitur nga qarqet nacionaliste serbe (ASSHA, KOS, LSHS) për eliminimin e autonomisë së Kosovës dhe centralizimin e RSFJ-së apo të synimeve për krijimin e një hegjemonie serbe në RSFJ, që në fakt nënkuptonte një Serbi të madhe, si dhe rezistencën e shqiptarëve ndaj synimeve të tilla.

Në fund, ka hartuar konkluzionet, të cilat provojnë të japin një dëshmi analizuese dhe krahasuese rreth zhvillimeve në fjalë, bazuar nga dokumentacioni në dispozicion.

Informacione lidhur me gjendjen në fushën shkencore në të cilën është punuar disertacioni

Sedat Kryeziu, kandidat për gradën shkencore doktor ka kryer një studim të thelluar në fushën e historisë bashkëkohore, një studim të bazuar e shumëdimensional përmes interpretimit objektiv të fakteve dhe argumenteve.

Për ta përgaditur këtë tezë studimi kandidati ka shfrytëzuar disa fonde të rëndësishme nga disa arkiva, pra materiale arkivore të pabotuara që janë hulumtuar në **Arkivin Shtetëror të Kosovës** (Fondi i Komitetit Krahinor të Kosovës 1981 -1988), në **Drejtorin e Përgjithshme të Arkivave në Shqipërisë** (Fondi i Komitetit Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë), pastaj **Arhiv Republike Slovenije** (Fondi: Централни Комитет Комунистички Лиге, Škatla 872-KOSOVO) si dhe një game të gjerë literature në gjuhën shqipe, angleze, e serbe.

Po ashtu janë shfrytëzuar revista, periodikë dhe gazeta ditore të cilat kanë përcjellë kronologjinë e zhvillimit të ngjarjeve dhe njëkohësisht kanë ndjekur edhe metodologjinë e ballafaqimit të fakteve të ofruara nga dy palët – shqiptarët dhe serbët. Një hapësirë të konsiderueshme zë edhe shfrytëzimi i burimeve elektronike – online.

Ajo që tërheq më tepër vëmendjen është se doktoranti duke shfrytëzuar lëndën burimore, si dhe literaturën relevante sipas metodës së kritikës së argumenteve, arrinë në rezultate të mira dhe të pakontestueshme rreth çështjes së nacionalizmit serb dhe konsekuencat që kishte te shqiptarët.

Përshkrim i shkurtër i metodave të përdorura

Metodologjinë e kërkimit, doktoranti e ka orientuar në atë drejtim që të ndriqohet nacionalizmi serb që në gjenezën e tij duke shfrytëzuar këndvështrime të ndryshme, që në totalitet krijojnë një pasyqër të qartë të nacionalizmit. Nacionalizëm që ka ndryshuar nëpër etapat

e historisë, ka marrë forma të ndryshme por, asnjëherë pa e ndryshuar përmbajtjen e tij shoviniste. Po ashtu gjatë punës hulumtuese është bërë krahasimi në mes të dhënave arkivore, shtypit të kohës dhe atyre të publikuara. Metodologjia e përdorur në këtë studim është ajo e qasjes tematike. Nuk mungojnë as metodat tjera të kërkimit shkencor sikurse përshkrimi, hulumtimi, analiza dhe krahasimi. Përdorimi i këtyre metodave ka pasur për qëllim të mos e cenojë kohezionin dhe të jetë në përputhje me kronologjinë kohore.

Paanshmëria në interpretimin e dokumenteve, ballafaqimi dhe krahasimi i qëndrimeve dhe lidhjet logjike që dalin nga sinteza e të dhënave dokumentare u shndërruan në boshtin kryesor në nxjerrjen e përfundimeve.

Sa u përket metodave hulumtuese, kandidati doktorant ka shfrytëzuar një numër të madh të metodave që i kanë ndihmuar në realizimin e kësaj teme. Veçanërisht është ka zbatuar Metoda historike përmes së cilës kandidati ka trajtuar dukuritë shoqërore që ndikuan në zhvillimin e ngjarjeve historike, në mënyre kranologjike nga e periudha më e hershme deri tek e sotmja. Përmes kësaj metode jam munduar ta bëjë interpretimin tërësor të zhvillimeve që ndodhën në periudhën 1981 - 1989, atëherë kur nacionalizmi doli sheshazi. Mirëpo gjithnjë sipas metodes historike, nacionalizmi nuk mund të analizohej në të gjitha dimensionet pa u kthyer në zanafillën e tij. Andaj për të qenë studimi më komplementar është shtrirë që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore e këtej. Përmes kësaj metode shkencore, autori ka trajtuar lëndën arkivore, literaturën e pasur, revista, periodik e posaçërishtë mediat e kohës të cilat nxjerrin në pah aktivitetin politik të viteve 1981/89, aty ku edhe është fokusimi kryesor i studimit të autorit.

Në masë të konsiderueshme është mbështetur edhe në metodën e analizës së fakteve - dëshmive të shkruara, me që ka qenë pothuaj se e vetmja mundësi që të trajtohet kjo temë përmes përmes kësaj metode shkencore, e cila e ka ndihmuar shumë në realizimin e temës. Duke i analizuar dëshmitë arkivore, literaturën, shtypin e kohës, autori ka nxjerr përfundime dhe ka marrë shtytje për vazhimin e studimit. Përpos dy medova të lartëcekura, metodë efikase që i ka shërbyer në punimin e temës ka qenë edhe metoda e krahasimit. Në disa raste materialet e shfrytëzuara si dokumentet arkivore, revistat shkencore, gazetatat e literatura shkencore ishin në kundërshtim njëra me tjetrën, por jo gjithmonë.

Gjithashtu në punimin e kësaj teme, kandidati ka përdorur edhe metoda tjera të dobishme për punimin siç janë: Metoda e vështrimit, Metoda e studimit empirik, Metoda eksperimentale,

përmes të cilave ka bërë përpjekje që të sjell sa do pak fakte dhe të dhëna të reja për temën që e ka trajtuar.

Përshkrim i shkurtër i rezultateve të hulumtimit

Mundësia e hyrjes o-nline në Arkivin shtetëror të Kosovës dhe në Drejtorinë e Përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë, kandidatit i ka krijuar mundësi të gjejë fonde të rëndësishme, siç janë: Fondi i Komitetit Krahinor të Kosovës 1981 -1988 dhe Fondi i Komitetit Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, e që i përkonin drejtpërdrejtë me temën e tij. Së fundi, në kuadër të punës hulumtuese ka arritur të sigurojë edhe disa fonde që janë marrë nga Arhiv Republike Slovenije (Fondi: Централни Комитет Комунистички Лиге, Škatla 872-KOSOVO) të cilat kanë ndikuar në arritjen e disa përfundimeve me interes për studimin e tij, gjithnjë duke u bazuar në këto dokumente burimore.

Po ashtu, doktoranti ka arritur të shfrytëzoj një game të gjerë të literaturës shkencore, e përzgjedhur në gjuhën shqipe, angleze, e serbe të cilat analizonin, vlerësonin e argumentonin periudhën që mbulon studimi i tij. Po ashtu janë shfrytëzuar revista, periodikë dhe gazeta ditore të cilat kanë përcjellë kronologjinë e zhvillimit të ngjarjeve dhe njëkohësisht kanë ndjekur edhe metodologjinë e ballafaqimit të fakteve të ofruara nga dy palët – shqiptarët dhe serbët. Një hapësirë të konsiderueshme zë edhe shfrytëzimi i burimeve elektronike – online. Shtypit të kohës, siç u përmend më lartë , kandidati i ka lënë një hapësirë të konsiderueshme. Të dhëna të një rëndësie të veçantë ka arritur ti siguroj nga shtypi i kohës, si nga ai shqiptar poashtu dhe ai serb.

Kontributet kryesore shkencore të kandidatit

Kandidati doktorant për gradën "doktor i shkencave historike", Sedat Kryeziu ka dhënë një kontribut për t'u admiruar në punimin e tij. Siç është e njohur, historiografia shqiptare, ndonëse, e ka trajtuar nacionalizmin serb në etapat më të hershme historike, nuk ka ndonjë studim të veçantë për këtë fenomen gjatë viteve në fjalë, ku edhe ato pak studime janë të fragmentuara. Në këtë mënyrë teza: **"Ridalja e nacionalizmit serb pas vdekjes së Titos dhe forcimi i politikës antishqiptare në Kosovë dhe Maqedoni në vitet 1981 - 1989"**, pretendon të ofrojë një studim të thelluar e gjithëpërfshirës, ku do të analizohen faktorët, që çuan në zgjimin e nacionalizmit serb, mënyrës, formës dhe rrethanave që ndikuan në zhvillimin e tij, si dhe pasojave që ai prodhoi për shqiptarët në veçanti, gjatë viteve në fjalë.

Kandidati, me punën e tij të bërë, ka pasur për qëllim që përmes një objektiviteti shkencor të shtjellojë zhvillimin e rrethanave dhe të faktorëve që çuan në rishfaqjen e nacionalizmit serb në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë, manifestimin e këtij nacionalizmi dhe pasojat që ai prodhoi për popujt tjerë jo serb në Jugosllavi, me theks të veçantë në Kosovë e Maqedoni, si dhe reagimin, ballafaqimin dhe qëndrimin e shqiptarëve kundrejt një politike të tillë gjatë viteve 1981-1989.

Shtjellimi i fenomenit të nacionalizmit serb është një temë e gjerë trajtimi i së cilës kërkon një studim të thellë e shumë-dimENSIONAL, prandaj teza fokusohet vetëm gjatë periudhës 1981-1989. Përzgjedhja e periudhës në fjalë nuk është e rastësishme, ajo në fakt ngërthen në vete zhvillimin dhe rezultatet finale të nacionalizmit serb që zanafillën e kishin në procesin e decentralizimit të RSFJ-së, autonominë e krahinave, sidomos të Kosovës, dhe frikës nga shpërbërja e Jugosllavisë dhe humbjes së qëllimit tradicional të nacionalizmit serb – vendosjes së hegjemonisë serbe në RSFJ. Në këto rrethana, vdekja e Titos dhe demonstratat studentore të shqiptarëve në Kosovë më 1981 ndezën zjarrin e kamufluar të nacionalizmit serb. Pra, këtu qëndron edhe risia e këtij punimi që të ofrojë një studim të bazuar e shumëdimensional, përmes interpretimit objektiv të fakteve dhe të argumenteve, të cilat janë analizuar për të qenë sa më bindës, por gjithnjë duke qenë i kujdesshëm që mos të humbë rrjedhën logjike e kronologjike të ngjarjeve

Në kuadër të saj, për ti zbërthyer sa më detajisht nacionalizmin dhe projektet nacionaliste, kandidati ka botuar edhe dy punime shkencore , ashtu siç parashihen në rregulloren për studime në ciklin e tretë të doktoratures. Të njëjtat, kandidati i ka mbrojtur para panelit, në Konferencën e organizuar nga Fakulteti Filozofik, me datë:29 shkurt 2019. Punimin e parë me titull: *"Vështrim i shkurtër mbi disa nga projektet serbe për shpërnguljen e shqiptarëve dhe krijimin e Serbisë së Madhe"* e ka botuar në Revistën shkencore periodike "GLOBAL CHALLENGE", që është botim i Akademisë Diplomatike Shqiptare, në maj 2017, si dhe punimin e dytë, të titulluar, *"Memorandumi i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë (ASHAS) i vitit 1986 dhe impakti i tij në ringjalljen e nacionalizmit serb"*, në revistën shkencore "KOSOVA", 44 - 2019. KDU: 94 (05), që botohet nga Instituti i Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë.

Memorandumi Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve(ASSHA) të vitit 1986, që ishte çelësi programor i gjitha veprimeve shkatërrimtare të serbëve në Jugosllavi. Se sa kishte përgjegjësi politike Memorandumi vërehet edhe të hapat politikë që i propozonte, e që ushtruan ndikim të padiskutueshëm në formësimin e politikës millosheviqiane, siç ishin: Revidimi i kushtetutës së vitit 1974, "Ribashkimi" i Serbisë dhe luftimi i "agresionit shqiptar" përmes "shpalljes luftë", përmes "luftës revolucionare" dhe të "konfrontimit të hapur". Që nga vitet 1989 /90 të gjithë këta hapa u bënë vërtetësi.

Fushën shkencore në të cilën do të aplikohen

Punimi i disertacionit të cilën e ka punuar kandidati Sedat Kryeziu, mund të gjejë aplikim në disa fusha. Përveç fushës së historiografisë, me të cilën tema specifikisht ka të bëjë, mund të aplikohet edhe në fusha tjera siç janë shkencat politike, juridike, pastaj demografinë dhe më pakë ato ekonomike.

Kandidati, tematikës politike i është qasur në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke i analizuar rrethanat politike që nga Lufta e Dytë Botërore e deri tek fillimvitet e '90, posaçërisht vitet 1981/ 89. Gjatë këtyre viteve, për shkak të problemeve etnike Jugosllavia ka hyrë në vorbullën e nacionalizmit ekstrem. Fenomenit të nacionalizmit i cili është edhe boshti i temës, kandidati i është qasur në mënyrë ekskluzive duke e trajtuar fenomenologjinë që nga zanafilla, pastaj paraqitja e tij nëpër fazat e ndryshme. Siç e kemi të njohur, efekti i nacionalizmit serb solli në

pushtet Slllobodan Millosheviqin. Premtimet e tij ishin për ribashkimin e Serbisë, që nënkuptonte rikthimin e hegjemonisë serbe në Jugosllavi e cila ishte defaktorizuar nga miratimi i Kushtetutës së vitit 1974. Duke përdorur kartën nacionaliste nxiti popullatën serbe në mitingje të mëdha, përmes të cilave arriti ti ndërroj pushtetet në Mal të Zi, Vojvodinë dhe së fundi në Kosovë, duke vënë në krye të tyre njerëz të besueshëm nga ai.

Nënshtrimi i Kosovës bëri që nacionalizmi serb të konsiderojë veten si një fuqi, që nuk kishte të ndalur, prandaj do të vazhdojnë objektivat serbe drejt bashkimit të të gjithë serbëve në një shtet, respektivisht, krijimit të një Serbie të Madhe. Kjo politikë nacional - shoviniste, si pasojë, pati gjakderdhjen dhe viktimizimin e popullsisë të pafajshme: kroate, boshnjake dhe shqiptare nga regjimi shovinist serb.

Siç u cek më lartë, studimi i kandidatit mund të gjejë aplikim edhe në shkencat juridike, sepse një pjesë e madhe e kapitullit të dytë i është kushtuar Kushtetutës së vitit 1974.

Dekretimi i kësaj Kushtetute vlerësohet si e arritura më e madhe e popullsisë shqiptare në Kosovë. Ndryshimet kushtetuese të vitit 1974 i siguruan Kosovës një avancim në statutin e krahinës autonome në aspekt të kompetencave legjislative e ekzekutive, e për më tepër të qenit subjekt i barabartë në federatën jugosllave. Krahina Socialiste Autonome e Kosovës sipas Kushtetutës së vitit 1974 kishte kompetenca ta organizonte jetën shoqërore e politike në Kosovë, kompetencat e saj shtriheshin në gjitha sferat si: arsimi, shëndetësia, planifikimi hapësinor, mbrojtja, siguria publike, drejtësia, e drejta e miratimit të ligjeve, kompetenca në politikën e jashtme, etj., kurse varësia me Serbinë ishte formale, dhe jo hierarkike. Për më tepër, krahinat autonome, pra Kosova e Vojvodina, kishin edhe të drejtën e vetos në nivel federativ e republikan.

Këto shkaktuan një brengosje serioze tek qarqet nacionaliste serbe, të cilat e kishin filluar procesin e ri-organizimit të tyre qysh më 1969 me rastin e ndryshimeve kushtetuese në Jugosllavi. Tek këto qarqe lindi frika se ngritja e vetëdijes kombëtare shqiptare mund të çoj në shkëputjen e Kosovës nga Serbia, sidomos kur Kosova posedonte tipare të një organizimi autonom shtetëror. Prandaj, përmes një presioni të heshtur qarqet politike serbe filluan përpjekjet për ndryshimin e Kushtetutës së vitit 1974, në veçanti të pjesëve që kishin të bënin me kompetencat e krahinave dhe lidhjen e tyre me Serbinë. Propozimet dhe arsyetimet e këtyre ndryshimeve u përfshinë në Librin e kaltër (1977), por që u hodhën poshtë nga udhëheqja

federative në krye me Titon. Procesi për dryshimet kushtetues do fillon të konkretizohet pa ardhjes së Millosheviqit në pushtet dhe që do marrë epilog me 23 mars 1989.

Në analizën e tij për ti shtjelluar disa nga aspektet e kushtetutës, kandidati është mbështetur në punimet e konstitucionalisteve më të njohur shqiptar dhe të huaj që kanë tematikë e kanë trajtuar jashtëzakonisht me profesionalizem.

Çështjet demografike kanë marrë një hapësirë të veçantë, pasi që kandidati i ka trajtuar shpërnguljet e popullatës shqiptare nga Kosova dhe viset e tjera në ish Jugosllavi, gjithnjë duke ju referuar autorëve më kredibil, të huaj dhe shqiptar.

Hulumtime të mundshme të ardhshme

Teza e disertacionit të doktorantit, Sedat Kryeziu, posedon një bibliografi të pasur. këtu përfshihen fonde arkivore të papublikuara deri më tani, siç janë ato nga Agjencioni i Arkivave të Kosovës, Drejtoria e përgjithshme e Arkivave të Shqipërisë, si dhe disa fonde interesante dhe me rëndësi të veçantë për studimin e tij. Më tej, një numër të burimeve dokumentare që janë publikuar, si dhe një listë të gjatë të botimeve nga autorë të përzgjedhur të cilët janë marrë me këtë periudhë. Kësaj liste të gjatë i bashkëngjiten edhe revista të ndryshme shkencore, periodikë si dhe gazeta ditore që e kanë përcjellë kronologjinë e ngjarjeve të asaj kohe. Bile këto i kanë mbuluar zbrazësitë që i kanë krijuar mungesa e dokumenteve. Një vend të rëndësishëm zënë edhe burimet e shkarkuara nga interneti, që përbëjnë një suplement të rëndësishëm në shkrimin e këtij disertacioni.

Në të ardhmen, kandidati synon që ta zgjeroj hulumtimin, grumbullimin dhe përpunimin e materialeve të reja, si atyre arkivore, po ashtu edhe për bibliografi të re. Në një fazë të mëvonshme, kandidati ka për qëllim botimin e kësaj teme, pasi që mendon se tematika e saj për nacionalizimin është me interes të veçantë për lexuesin shqiptar, pasi që kjo konsiston edhe me situatën aktuale. Për atë fazë synohen hulumtime të reja në arkivat e Serbisë, pasi që për këtë periudhë ishte e pamundur. Hulumtimi në këto arkiva përbën një interes të veçantë për kandidatin dhe për temën të cilën ai e trajtonë.

Përfundim me propozim deri te Këshilli-mësimor shkencor

Punimi i doktoraturës të kandidatit Sedat Kryeziu " Ridalja e nacionalizmit serb pas vdekjes së Titos dhe forcimi i politikës antishqiptare në Kosovë dhe Maqedoni në vitet 1981 - 1989", që i propozohet Këshillit - mësimor shkencor i përmbush kriteret e një punimi të doktoraturës për të marrë gradën shkencore "Doktor i shkencave të historisë".

Teza e doktoraturës së kandidatit Sedat Kryeziu është një qasje serioze shkencore. Autori ka qenë i vetëdijshëm për idenë e një punimi kompleks, andaj ky na paraqet një studim gjerësisht dhe thellësisht të trajtuar si në aspektin politik ashtu edhe atë juridik, e aspekte tjera. Ajo që është pozitive qëndron në faktin se teza në fjalë e doktoraturës është një përpjekje e parë që në nivel të doktoraturës të trajtohet çështja e nacionalizmit si fenomen dhe tërë pasojat që rrodhën nga ai.

Teza e kandidatit Sedat Kryeziu, konsiston në dhënien e provave të mjaftueshme për të dëshmuar marrjen e kësaj grade shkencore. Rrjedhimisht konsiderojmë se kandidati ka ofruar në studimin e tij rezultate të kënaqshme në pasqyrimin dhe argumentimin e një pasqyre të përgjithshme të ridaljes së nacionalizmit serb pas vdekjes së Titos si dhe të forcimit të politikës antishqiptare në Kosovë dhe Maqedoni gjatë viteve 1981 - 1989. Puna intenzive e autorit ka rezultuar me suksese në ballafaqimin e argumenteve të sjella deri më tani të historiografisë më të re shqiptare, serbe dhe asaj me proviniençë perendimore. Kjo do të thotë se teza e doktoratës e kandidatit është finalizuar me sukses të plotë.

Nënshkrime të të gjithë anëtarëve të komisionit vlerësues të disertacionit(nëse nuk kemi mendime të ndara)

Që këtej, nga e gjithë ajo që u tha më sipër, teza e doktoraturës **“Ridalja e nacionalizmit serb pas vdekjes së Titos dhe forcimi i politikës antishqiptare në Kosovë dhe Maqedoni në vitet 1981 ~ 1989”** i plotëson të gjitha kriteret e një studimi shkencor dhe provon se autori i tij **Sedat Kryeziu** zotëron potencial të mirë shkencor për t’iu qasur punimeve serioze shkencore nga lëmi i historisë bashkëkohore, andaj komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të këtij disertacioni, në përbërje të mëposhtme, ka nderin që ti propozoj Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit Filozofik miratimin e këtij raporti dhe të krijoj kushte për mbrojtjen publike të këtij disertacioni të doktoraturës.

Komisioni recenzues:


1. Prof. Dr. Zeqirja Idrizi (Kryetar)

2. Prof. Dr. Fehari Ramadani (anëtar)

3. Prof. Dr. Zeqirja Rexhepi (anëtar)

4. Prof. Dr. Isak Sherifi (anëtar)

5. Prof. Dr. Nebi Dervishi (Mentor)



The image shows five handwritten signatures in blue ink, each written over a horizontal line. The signatures correspond to the names listed in the list above. The first signature is the most prominent and appears to be 'Zeqirja Idrizi'. The other signatures are less legible but appear to be 'Fehari Ramadani', 'Zeqirja Rexhepi', 'Isak Sherifi', and 'Nebi Dervishi'.